EPOKA E RE
E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6979
E shtunë, 26 gusht 2023
Çmimi 0.40

## Hapet platforma për subvencionimin e teksteve shkollore

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MINISTRI I RI I MBROJTJES, EJUP MAQEDONCI, KA MBAJTUR TË PREMTEN KONFERENCË PËR MEDIA FAQE 4-5

# MAQEDONCI: FOKUSI YNË MBETET ANËTARËSIMI NË NATO



Ministri i ri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci ka thënë se fokusi i Kosovës mbetët anëtarësimi në NATO. Në një konferencë për media të premten, Maqedonci ka folur për objektivat kyçe të Ministrisë Mbrojtjes, duke theksuar se do të punojnë në zhvillimin e kapaciteteve ushtarake në përputhje me standardet e Aleancës Veriatlantike. Ai ka thënë se prioritet i Ministrisë së Mbrojtjes është zhvillimi i kapaciteteve ushtarake në funksion të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial, duke theksuar se do të vazhdojnë investimet në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe operacionale të Forcës së Sigurisë së Kosovës

## PDK-JA MBAN MBLEDHJEN E KRYESISË: ZGJEDHJE TË PARAKOHSHME SA MË PARË



## GËRXHALIU: NGA FUNKSIONALIZIMI I BYROSË PËR KONFISKIMIN E PASURISË MË SË SHUMTI DO TË GODITET DIASPORA

FAQE 7



## AKTUALE



### DONALD TRUMPI BËHET ISH-PRESIDENTI I PARË AMERIKAN QË I BËHET FOTO NGA BURGU F. 2

### ESCOBAR NË SHKUP: NUK JAM KËTU PËR TORTURA, DUAM T'JU SHOHIM NË BE F. 2

### PRESIDENTJA OSMANI VIZITË ZYRTARE NË SHQIPËRI MË 4 E 5 SHTATOR F. 7

## EKONOMI



### KOMUNAT E DËRGOJNË NË KUSHTETUESE LIGJIN PËR TATIMIN NË PRONË F. 8

### AVOKATI HALIMI: RIDVAN MUHARREMI ËSHTË TAKUAR ME ROZETA HAJDARIN NË ZYRËN E SAJ F. 8

## SPORT



### RAMADANI: SERIE A E KISHA ËNDËRR FËMIJËRIE F. 10

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Donald Trumpi bëhet ish-presidenti i parë amerikan që i bëhet foto nga burgu



**Uashington, 25 gusht-** Donald Trump u dorëzua të enjten në mbrëmje tek autoritetet e Xhorxhias për t'u përballur me akuzat për përpjekjet për përmbysjen e zgjedhjeve të vitit 2020 në atë shtet, një proces që zgjati vetëm 20 minuta dhe që përfshiu një element historik: fotografimin për herë të parë nga policia të një ish-presidenti amerikan si i dyshuar.

Ish-presidenti u la i lirë kundrejt një garancie prej 200,000 dollarësh dhe u kthye në aeroport për t'u rikthyer në Nju Xhersi, ku ai ka një nga rezidencat e tij.

Përpara se të hipte në avionin e tij privat në aeroportin Hartsfield-Jackson të Atlantës pas procedurës së dorëzimit, ish-presidenti Trump përsëriti pretendimin e tij se prokuroria në Xhorxhia ashtu si prokurorët në paditë e tjera me të cilat ai përballet - është e motivuar politikisht. "Ajo që po ndodh këtu është një farsë e sistemit të drejtësisë", u tha ai gazetarëve. "Nuk kam bërë asgjë të gabuar dhe të gjithë e dinë këtë".

Dorëzimi i ish-presidentit Trump tek autoritetet e zbatimit të ligjit është bërë tashmë një pamje e zakonshme. Është hera e katërt që ndaj tij ngrihet një aktpadi, diçka e pashembullt për një ish-president, aq më tepër gjatë një sezoni zgjedhor ku ai po kandidon për t'u rikthyer në Shtëpinë e Bardhë.

# Escobar në Shkup: Nuk jam këtu për tortura, duam t'ju shohim në BE

**Shkup, 25 gusht -** I dërguari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka deklaruar të premten në Shkup se ShBA-ja e inkurajon Maqedoninë e Veriut që ta vazhdojë rrugën e integrimit evropian, pasi siç tha ai, "ShBA-ja dëshiron ta shohë këtë vend pranë strukturave evropiane".

Ndryshimet kushtetuese për përfshirjen e pakicës bullgare në preambulën e saj, si popull shtetformues, janë pjesë e Marrëveshjes së Shkupit me Sofjen, dhe kusht për Maqedoninë e Veriut për vazhdimin e bisedimeve me BE-në për anëtarësim në bllokun evropian.

Diplomati amerikan në Shkup është pritur nga presidenti i vendit Stevo Pendarovski dhe



kryeministri Dimitar Kovaçevski, ndërsa do të ketë takim edhe me liderin e opozitës maqedonase, Hristijan Mickoski.

Pas takimit me kryeministrin Dimitar Kovaçevski, Escobar ka thënë se shpreson që Kuvendi i Maqedonisë së Veriut, do të vazhdojë me procesin e miratimit të ndryshimeve kushtetuese. "Duam t'ju shohim në Bashkimin Evropian. Ju jeni anëtare e Këshillit eurotlantik, kështu që duam që të jeni sa më pranë strukturave evropiane. Më vjen mirë që ka nisur ky proces dhe shpresoj se do të vazhdojë", ka deklaruar Escobar.

Diplomati amerikan tha se mesazhet e njëjta do t'ia përcjellë edhe kryetarit të VMRO DPMNE-së, Hristijan Mickoski, i cili para takimit ka thënë se "Escobar është i mirëseardhur për t'i dëgjuar argumentet e tij kundër ndryshimeve kushtetuese, por jo edhe për presione dhe tortura kur bëhet fjalë për këtë çështje".

Escobar tha se "partnerë natyralë" të ShBA-së do të jenë të gjithë ata që janë të përkushtuar për integrimin evropian, NATO-n dhe luftën kundër korrupsionit. "Dua të them askush këtu nuk do t'iu nënshtrohet torturave. ShBA-ja nuk bën zgjedhjen e qeverive të anëtarëve të NATO-s. Megjithatë, ne kemi pritje dhe do ta përcjell mesazhin e njëjtë sikur në gjithë rajonin se, ShBA-ja i sheh si partnerë natyralë ata që janë të përkushtuar në integrimin evropian, në NATO dhe luftën kundër korrupsionit".

Kryeministri Dimitar Kovaçevski tha ndërkohë se mbështetja e fuqishme nga faktori ndërkombëtar, për vazhdimin e procesit të integrimit evropian përmes miratimit të ndryshimeve kushtetuese, "dëshmon rrugën e drejtë të institucioneve të Maqedonisë së Veriut". "ShBA-ja ka qenë dhe do të jetë me ne. Është mbështetësja më e madhe që nga pavarësia e Maqedonisë së Veriut dhe do të vazhdojë të na mbështesë", ka thënë Kovaçevski.

Ai i ka hedhur poshtë pretendimet e opozitës maqedonase se "ndryshimet kushtetuese dëmtojnë interesat maqedonase, andaj edhe refuzojnë mbështetjen e tyre".

# Inteligjenca britanike: Prigozhin ka shumë gjasa të ketë vdekur, por ende s'ka konfirmim

Londër, 25 gusht- Ministria e Mbrojtjes e Britanisë thotë se ka "shumë gjasa" që themeluesi i grupit mercenar rus Wagner, Yevgeny Prigozhin, të jetë vdekur nga rrëzimi i avionit në fillim të kësaj jave, megjithëse konfirmimi përfundimtar nuk ka ardhur ende nga zyrtarët rusë që hetojnë aksidentin.

Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, në fjalimin e tij të parë që nga rrëzimi vdekjeprurëse që vrau të dhjetë personat në bordin e avionit, foli më 24 gusht për Prigozhinin duke i shprehur fjalitë e tij në kohën e kaluar, ndërsa u dërgoi ngushëllimet e tij familjeve të viktimave. Emri i Prigozhinit ishte në listën e pasagjerëve të avionit.

Por, Putin nuk e konfirmoi zyrtarisht vdekjen e liderit të Wagnerit dhe Ministria Britanike e Mbrojtjes tha në një konferencë të inteligjencës më 25 gusht se megjithëse nuk ka ende "prova përfundimtare" që Prigozhini ishte në bord, "ka shumë gjasa që ai të jetë vërtet i vdekur". "Ai [Prigozhin] ishte një njeri i talentuar", tha Putin më 24 gusht, por gjithashtu shtoi se ai ishte "një njeri me fat të vështirë [i cili] kishte bërë gabime të rënda në jetë". "Ngushëllimet e mia të sinqerta për familjet e të gjithë atyre që humbën jetën", shtoi ai.

Putin nuk i specifikoi "gabimet" e bëra nga njeriu që vetëm dy



muaj më parë udhëhoqi një rebelim jetëshkurtër kundër ushtrisë. Prigozhin nuk u arrestua pas kryengritjes, por Putin e denoncoi kryengritjen si një "thikë pas shpine" dhe u zotua se do t'i ndëshkonte të gjithë "tradhtarët" e përfshirë.

Hetuesit janë duke analizuar rrënojat e avionit privat që i përkiste grupit Wagner, i cili u rrëzua gjatë rrugës për në Shën Petersburg nga Moska, duke mos lënë asnjë pasagjer të mbijetuar.

Vëzhguesi i fluturimeve Flightradar24 tregoi një avion brazilian Embraer 600 të regjistruar në emrin e grupit Wagner duke u zhdukur nga radarët herët në mbrëmjen e 23 gushtit. Menjëherë pas kësaj, u shfaqën video në rrjete sociale, ku shihej një aeroplan duke rënë nga qielli në një zonë rreth 300 kilometra në veri të Moskës, që përkonte me vendndodhjen e zhdukjes së avionit.

Pyetjet se a ishte Prigozhin në aeroplan apo jo, dhe rrethanat se përse u rrëzua avioni kanë çuar në spekulime se Putini qëndron prapa rrëzimit të avionit.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Shtyhet aksioni për largimin e institucioneve të Serbisë nga objekti komunal në Mitrovicë të Veriut

MITROVICË E VERIUT, 25 GUSHT- Komuna e Mitrovicës së Veriut shtyu aksionin për largimin e institucioneve të Serbisë nga objekti i saj në Lagjen e Boshnjakëve, konfirmuan për "Radion Evropa e Lirë" nga kabineti i kryetarit të komunës, Erden Atiq. "E kemi zhvendosur datën për dy javë. Pas dy javësh do të merret vendimi sipas planit të paraparë", tha shefi i kabinetit të kryetarit, Visar Syla.

Arsyet e këtij vendimi, tash për tash, nuk janë të qarta.

Zyra për Kosovën e Qeverisë së Serbisë, Drejtoria e Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor, Qarku Administrativ i Mitrovicës së Kosovës dhe Qendra për Punë Sociale nga Vushtrria gjenden në atë objekt prej kohësh.

Më 22 gusht, inspektorati komunal kërkoi prej tyre që, brenda tri ditësh, ta lirojnë objektin, për shkak se nuk dorëzuan dokumente apo kontrata për shfrytëzimin e tij.

Autoritetet komunale thanë se objekti është pronë e tyre dhe se duhet të lirohet për shkak të disa "punimeve". Por, në një deklarim për "Radion Evropa e Lirë", ato nuk specifikuan se për çfarë lloj punimesh bëhet fjalë.

Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Veriut, Erden Atiq, vjen nga Lëvizja Vetëvendosje e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti.

Qeveria e Kosovës nuk deshi ta komentojë këtë vendim të Komunës së Mitrovicës së Veriut, me arsyetimin se bëhet fjalë për "çështje lokale".

Megjithatë, Ambasada amerikane në Prishtinë ka këshilluar edhe Qeverinë e Kosovës, edhe kryetarët e komunave me shumicë serbe në veri që "të përmbahen nga ndërmarrja e çfarëdo veprimi që mund t'i rrisë tensionet".

Popullata serbe në veri të Kosovës i bojkotoi zgjedhjet lokale të prillit dhe, si rezultat, pushtetin në komunat Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq e morën kryetarët shqiptarë.

Në fund të majit, këta kryetarë, me ndihmën e policisë, hynë në ndërtesat komunale - gjë që shkaktoi revoltë nga popullata lokale serbe dhe ngriti tensionet.

Situata u përshkallëzua më 29 maj në Zveçan, kur serbët u përleshën me pjesëtarët e misionit ushtarak të NATO-s në Kosovë, KFOR.

Dhjetëra të plagosur u raportuan në të dyja anët.



## I kujt është objekti komunal në Mitrovicë të Veriut?

Objekti i diskutueshëm, për të cilin të dyja palët pretendojnë se është i tyre, është ndërtuar në periudhën e paraluftës.

Ligji për agjencinë kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës e rregullon çështjen e objekteve të tilla.

Ky ligj ka hyrë në fuqi në vitin 2016, pas së cilës gjë është formuar Agjencia Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronës, mandati i së cilës, ndër të tjera, është t'i zgjidhë çështjet e pronave që ka qenë të Serbisë deri në qershor të vitit 1999.

Lista Serbe - partia më e madhe e serbëve në Kosovë - ka qenë kundër këtij ligji dhe ka kërkuar që Gjykata Kushtetuese ta shpallë atë jokushtetues. Megjithatë, kjo nuk ka ndodhur.

Lista Serbe tha më 22 gusht se "kryetarët e paligjshëm kanë shkuar një hap më tej dhe duan të na i marrin hapësirat".

Por, nga Komuna e Mitrovicës së Veriut thanë se zyrtarët e tyre janë pritur nga nënkryetari i Listës Serbe, Igor Simiq, i cili u ka thënë se "nuk ka asnjë dokument për objektin" dhe se "nuk e di se në pronësinë e kujt është".

Simiq, përndryshe, është kryetar i Drejtorisë së Fondit të Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore, i cili ndodhet në objektin e diskutueshëm.

# Hapet platforma për subvencionimin e teksteve shkollore

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 GUSHT - Në platformën online të Qeverisë së Kosovës, E-Kosova, është hapur më 25 gusht linku ku prindërit mund të aplikojnë për sigurimin e të hollave për blerjen e teksteve shkollore për fëmijët e tyre.

Pas hapjes së aplikimit është bllokuar platforma E-Kosova, në të cilën shfaqej vazhdimisht vetëm mesazhi "ju lutem prisni, kërkesa juaj është në proces të sipërm".

Një ditë më parë, ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Kosovës (MASHTI), Arbërie Nagavci, njoftoi se për nxënësit nga klasa e parë deri në klasën e pestë do të ndahen nga 80 euro, ndërsa për ata nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë nga 30 euro.

Për t'i siguruar këto para për blerjen e teksteve shkollore, prindërit do të duhet të aplikojnë përmes platformës E-Kosova.

Duke iu drejtuar prindërve të nxënësve fillorë, përmes një videoje në llogarinë e saj në Facebook, Nagavci tha se "mjetet do të dalin në xhirollogaritë tuaja që nga fillimi i javës së ardhshme".

Në të kaluarën, MASHTI i ka shpërndarë falas librat për nxënësit e shkollave fillore nga viti 2008.

Por, Nagavci njoftoi në fillim të kësaj jave se ka ndryshuar mënyrën e shpërndarjes së teksteve shkollore, për shkak të dështimit të marrëveshjes me shtëpitë botuese për furnizimin e shkollave me libra, për faktin se, sipas saj, shtëpitë botuese kanë ofertuar çmime shumë më të larta se ato që i vendosin në libraritë e tyre.

Për rrjedhojë, Ministria do t'u deponojë prindërve të nxënësve mjete në llogari, në mënyrë që ata t'i blejnë vetë librat.

Ky vendim i ministres Nagavci është kundërshtuar nga opozita, e cila e ka kërkuar dorëheqjen e saj, si dhe nga vetë Këshilli i Prindërve i Kosovës.

Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBAShK), Rrahman Jasharaj, ka fajësuar Ministrinë e Arsimit për dështimin e marrëveshjes për sigurimin e librave nxënësit.




Në një intervistë për "Epokën e re", Jasharaj e ka quajtur ide të gabuar që prindërit të rimbursohen për blerjen e librave të nxënëseve.

Në këtë kontekst, ai ka thënë se nxënësit do të mbesin në mëshirën e ministres së Arsimit, Arbërie Nagavci dhe ministrit të Financave, Hekuran Murati, duke thënë se familje të shumta janë në gjendje të rëndë ekonomike.

Sipas Jasharajt, jo vetëm nxënësit por edhe mësimdhënësit do të hasin në vështirësi në fillim të vitit shkollor për shkak të mungesës së librave.




MINISTRI I RI I MBROJTJES, EJUP MAQEDONCI, KA MBAJTUR TË PREMTEN KONFERENCË PËR MEDIA

# Maqedonci: Fokusi ynë mbetët anëtarësimi në NATO

Ministri i ri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci ka thënë se fokusi i Kosovës mbetët anëtarësimi në NATO. Në një konferencë për media të premten, Maqedonci ka folur për objektivat kyçe të Ministrisë Mbrojtjes, duke theksuar se do të punojnë në zhvillimin e kapaciteteve ushtarake në përputhje me standardet e Aleancës Veriatlantike. Ai ka thënë se prioritet i Ministrisë së Mbrojtjes është zhvillimi i kapaciteteve ushtarake në funksion të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial, duke theksuar se do të vazhdojnë investimet në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe operacionale të Forcës së Sigurisë së Kosovës

EPOKA E RE **Mal QORRAJ**

**Prishtinë, 25 gusht**- Ministri i ri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka mbajtur të premten një konferencë për medie, në të cilën ka folur për objektivat e kësaj ministrie.

Ai ka thënë se prioritet i Ministrisë së Mbrojtjes është zhvillimi i kapaciteteve ushtarake në funksion të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial, fuqizimi i mbikëqyrjes demokratike civile dhe rritjen e llogaridhënies dhe transparencës, zgjerimi i bashkëpunimit bilateral, anëtarësimin në organizata ndërkombëtare dhe pjesëmarrjen në operacione ndërkombëtare, ruajtjen e kapaciteteve thelbësore në funksion të mbështetjes së autoriteteve civile. "Me një buxhet prej 123 milionë eurosh për vitin 2023, që është 120 për qind më shumë se në vitin 2021, e që aktualisht është shpenzuar rreth 58 për qind e tij, do të vazhdohet investimi me theks të veçantë në dy drejtime: ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe operacionale të Forcës së Sigurisë së Kosovës", ka thënë Maqedonci.

Ai ka thënë se ajo që do të theksojë është se aktualisht janë në proces të rekrutimit të edhe 612 ushtarëve aktivë dhe 388 pjesëtarëve të tjerë të komponentes rezervë, që në total e çon numrin e ushtarëve të rekrutuar gjatë 29 muajve të fundit në 2240 pjesëtarë. "Pra, pothuajse dyfishim të numrit të ushtarëve", ka thënë ai, duke shtuar se përvec rritjes së numrit të përgjithshëm të ushtarëve do të vazhdojë edhe investimi në përgatitjen profesionale të ushtarakëve përmes trajnimesh dhe shkollimesh ushtarake dhe profesionale. "Në përputhje me planin gjithëpërfshirës të tranzicionit, si prioritet gjatë mandatit tim do ta kem vazhdimin e investimeve në drejtim të ngritjes së kapaciteteve luftarake dhe blerjes së armatimeve, që në raport me qeverisje paraprake, tani ka arritur vlerën e trefishtë më të lartë", është shprehur ministri i Mbrojtjes.

Maqedonci ka thënë se synimi strategjik si shtet në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes është anëtarësimi në organizata ndërkombëtare, me theks të veçantë në NATO. "Do të angazhohemi maksimalisht në zgjerimin dhe thellimin e bashkëpunimit me shtetet anëtare të kësaj aleance por edhe përtej saj. Kjo edhe ngase duke u bazuar në hapat me të cilët është duke u zhvilluar FSK-ja, suksesin e treguar në misionet ndërkombëtare si në Lindjen e Mesme, në Ishujt Falkand, gjatë intervenimit në Turqi, si dhe rezultateve të larta të treguara në trajnimet përkrah forcave të ushtrive partnere, Kosova ka dëshmuar që përmes FSK-së, është e gatshme të ofroj kontribut në çështje të sigurisë globale", ka thënë ai.

# PDK-ja mban mbledhjen e Kryesisë: Zgjedhje të parakohshme sa më parë

PRISHTINË, 25 GUSHT- Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka mbajtur mbledhjen e kryesisë, në të cilën është diskutuar për aktualitetin politik në vend, përfshirë skandalet dhe aferat e njëpasnjëshme të qeverisë.

Partia Demokratike e Kosovës vlerëson se gjendja në Kosovë, për shtetin dhe qytetarët, është e rëndë dhe vjen si pasojë e paaftësisë qeverisëse, keqqeverisjes dhe abuzimeve të shumta. "Përfshirja e këtij pushteti në afera të ndryshme, prej atyre me energjinë, rezervat shtetërore, tekstet shkollore, trafikimin e substancave narkotike, keqmenaxhimin e institucioneve të ndryshme dhe keqpërdorimet e shumta të detyrave zyrtare - shpërfaqin karakterin e vërtetë të kësaj qeverie", thuhet në komunikatën e PDK-së.

PDK-ja shpreh shqetësimin e madh që si pasojë e kësaj qeverisjeje, mbi 150 mijë qytetarë e kanë lëshuar vendin në dy vitet e fundit.

Sipas kësaj partie, është rritur kosto e jetesës dhe çdo ditë po rritet numri i familjeve kosovare që po shkojnë drejt pragut të varfërisë. "Për më shumë, është dëmtuar mirëqenia e qytetarëve dhe progresi i shtetit, ku si pasojë e sanksioneve ndërkombëtare, janë dëmtuar aleancat strategjike të shtetit dhe Kosova ka humbur një sërë fondesh të mëdha ndërkombëtare. Pikërisht, nisur nga ky realitet i hidhur politik dhe ekonomik në vend, Këshilli Drejtues i PDK-së, në mbledhjen e mbajtur më 3 korrik 2023, kishte marrë vendim për pezullimin e çdo komunikimi zyrtar dhe ndërprerjen e bashkëpunimit institucional me kryeministrin Albin Kurti dhe presidenten Vjosa Osmani-Sadriu, si dhe Lëvizjen Vetëvendosje. Në këtë kontekst, Kryesia e Partisë Demokratike të Kosovës, si rezultat i mosrespektimit të këtij vendimi nga disa anëtarë të saj nga Dega në Gjilan, në mbledhjen e sotme ka vendosur që të përjashtojë nga të gjitha strukturat e saj, tre anëtarë: Leonora Morina-Bunjakun, Enver Shabanin dhe Bajram Isufin", thuhet në komunikatë, duke shtuar tutje se zyrtarët e përjashtuar nuk kanë zbatuar qëndrimet partiake dhe vendimin e Këshillit Drejtues të PDK-së edhe pas kërkesës me shkrim të datës 31 korrik 2023, të komunikuar zyrtarisht nga sekretari i Përgjithshëm i PDK-së, dhe kanë vazhduar të shërbejnë Lëvizjen Vetëvendosje në Komunën e Gjilanit, përkundër prishjes së koalicionit kohë më parë. "Gjatë këtij takimi u vlerësua shumë edhe organizimi i suksesshëm i 'Muajit të Rinisë' nga Rinia Demokratike e Kosovës, ku, përgjatë tërë muajit gusht janë në proces të realizimit 24 aktivitete nga më të ndryshmet, në shumicën e komunave të Kosovës. Të rinj e të reja të shumtë i janë bashkuar Rinisë Demokratike, duke shfaqur talentin e tyre, por edhe përkushtimin e vendosur që të kontribuojnë në ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë për ta", theksohet në komunikatë.

Partia Demokratike e Kosovës, përmes të gjitha organeve dhe zyrtarëve të saj, ka theksuar se mbetet e angazhuar që të mbrojë interesin e shtetit dhe të qytetarëve. "Për PDK-në, kjo qeveri tashmë e ka humbur çdo kredibilitet dhe nevoja për t'u rikthyer tek qytetarët, përmes zgjedhjeve të parakohshme, është e domosdoshme. Kosova, sot, para se gjithash, ka nevojë për një qeveri kredibile, të përgjegjshme, të aftë dhe e cila, në bashkëpunim me aleatët ndërkombëtarë, do ta rikthejë vendin në kursin e duhur të zhvillimit dhe integrimit euro-atlantik", është theksuar ndër të tjera në komunikatën e PDK-së.




## Përjashtimi i Kosovës nga "Defender Europe 23"

Muaj më parë Kosova u përjashtua nga stërvitja ushtarake ndërkombëtare i udhëhequr nga NATO "Defender Europe 23" si pasojë e parë për Qeverinë e Kosovës pas vendimit për të instaluar kryetarët shqiptarë në katër komunat veriore nën asistencën e Policisë së Kosovës, megjithatë sipas ministrit të ri të Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, Forca e Sigurisë së Kosovës nuk është penalizuar në aspektin operacional.

Përjashtimi i Kosovës nga stërvitja më e madhe të aleatëve të NATO-s në Ballkan, sipas Maqedoncit, ka qenë më shumë një reagim ndaj situatës, sesa ndonjë shkaktim i ndonjë lëndimi ndaj FSK-së në aspektin operacional. "'Defender Europe 23' si aktivitet nuk është anuluar, është anuluar pjesa përfundimtare e këtij ushtrimi që ka qenë dita e hapur për media dhe vizitorë të shquar për të përcjellë aktivitetin e 'Defender Europe 23'. Në aspektin operacional aktivitetet kanë përfunduar të gjitha deri në atë kohë, nuk jemi penalizuar në aspektin operacional ishte më shumë një reagim ndaj situatës", ka shpjeguar ai.

Maqedonci ka bërë me dije se Ministria e Mbrojtjes do të merr pjesë në konferencat planifikuese gjatë këtij vjeshte për "Defender Europe 25". "Jam i bindur që do të vazhdojmë me të njëjtën ritëm të bashkëpunimit me ShBA-të sa i përket ushtrimeve dhe trajnimeve", ka thënë ministri i Mbrojtjes.

## Bulliqi sheh nga afër punimet që po zhvillohen në projekte të ndryshme

**Podujevë, 25 gusht**- Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi i shoqëruar nga drejtori i Shërbimeve Publike, Bahri Selimi kanë përcjell disa prej projekteve që po realizohen gjatë kësaj kohe si; rregullimi i rrugëve me zhavor në fshatin Ternavë, ndërtimi i shtratit të lumit Llap në lagjen e Bebushëve në qytet dhe ndërtimi i shtigjeve të ecjes në fshatin Shakovicë.
Kryetari Bulliqi gjatë këtyre vizitave në terren u nda i kënaqur me dinamikën e punës që po zhvillohet në shumicën e projekteve kapitale në gjithë territorin e komunës, si dhe siguroi se puna në terren do të vazhdojë edhe më tutje sipas planit dinamik në përmbyllje të suksesshme të projekteve deri në fund të vitit.



# KOMF-i mbështet Ministrinë e Drejtësisë në hartimin e nëntë moduleve për ngritjen e kapaciteteve për shërbime sociale




**Prishtinë, 25 gusht**- KOMF-i gjatë muajve të kaluar ka mbështetur Ministrinë e Drejtësisë në hartimin e nëntë moduleve për ngritjen e kapaciteteve për shërbime sociale, që do të jenë pjesë e programit të trajnimit nën Departamentin e Politikave Sociale dhe Familjare dhe Këshillin e Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare. Këto module, do t'ju shërbejnë të gjithë ofruesve të shërbimeve sociale në ngritjen e kapaciteteve për ofrim sa më cilësor të shërbimeve sociale.
Në këtë drejtim, KOMF-i ka filluar të mbajë serinë e trajnimeve për ngritje ne kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve sociale, në të gjitha regjionet e Kosovës.
Ky aktivitet mundësohet në kuadër të projektit "Fuqizimi i akterëve të shërbimeve sociale për të ofruar shërbime cilësore dhe të qëndrueshme për fëmijët dhe familjet e cenueshme në Kosovë", dhe mbështetet nga Unicef Kosovo Programme në partneritet me USAID Kosovo.

# Drenas, zgjerohet programi "Vizitat në shtëpi për gratë shtatzëna dhe fëmijë të vegjël"

**Drenas, 25 gusht** - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e Komunës së Drenasit ka vazhduar me programin "Vizitat në shtëpi për gratë shtatzëna dhe fëmijët e vegjël" edhe në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Komoran.
Fillimisht, ky programi ka filluar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Drenas, e tash e tutje, do të ketë ekipet edhe në Komoran të cilat do bëjnë vizita tek nënat me fëmijë prej 0 deri në 3 vjeç, me fokus, gratë dhe fëmijët në zona rurale.
Ky program në sistemin parësor parandalon problemet eventuale shëndetësore si, probleme me dëgjimin, alergjitë e ndryshme e deri tek mënyra e të ushqyerit, si dhe duke mos anashkaluar as edukimin e nënave të reja në qasjen e kujdesit të tyre ndaj fëmijëve të porsalindur.
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka njoftuar se mbetet e përkushtuar në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për të gjithë banorët e kësaj komune.






# Në Prishtinë mbahet punëtoria dyditore trajtimi i kërkesave për qasje në dokumente publike

**Prishtinë, 25 gusht**- Komuna e Prishtinës në bashkëpunim me OSCE Mission in Kosovo dhe Agjencinë për Informim dhe Privatësi organizuan punëtorinë dyditore me temën "Balancimi i së drejtës për informim dhe së drejtës për privatësi", për zyrtarë nga të gjithë drejtoritë dhe departamentet që veprojnë në institucionin e kryeqytetit.
Komuna e Prishtinës ka njoftuar se qëllimi i kësaj punëtorie ishte trajtimi i kërkesave për qasje në dokumente publike, përmirësimi i ofrimit të qasjes në këto dokumente dhe mbrojtja e të dhënave personale në përputhje me Ligjin për qasje në dokumente publike dhe Ligjin për Mbrojtjen e të dhënave personale.

## Qindra të rinj të mbledhur në Film n'park

Prishtinë, 25 gusht- Film n'park po vazhdon të sjellë atmosferë fantastike në kinemanë e hapur në Parkun e Qytetit. "Hidden Figures" filmi që tregon historinë e triumfit të tri grave afro-amerikane në vitet e '60-ta, u ndoq nga ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku e shumë të rinj adhurues të zhanrit dramë dhe biografi. Përmes shfaqjes së filmave dhe aktiviteteve kreative, organizimet si këto aktivizojnë dhe emancipojnë të rinjtë. Ministria e Kulturës ka falënderuar të gjithë vullnetarëve që po e bëjnë organizimin të mundshëm e të përsosur.



## Kurti priti në takim lamtumirës drejtorin e Fondacionit Friedrich-Ebert-Stiftung

PRISHTINË, 25 GUSHT- Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti priti në takim lamtumirës drejtorin e Fondacionit Friedrich-Ebert-Stiftung për Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut, Rene Schlee, i cili tani do të drejtojë zyrën rajonale të këtij Fondacioni për Evropën Juglindore.

Gjatë bashkëbisedimit në këtë takim lamtumirës, kryeministri Kurti e falënderoi Schleen për punën, angazhimin, mbështetjen dhe bashkëpunimin.

Në qendër të bashkëpunimit ishin çështjet dhe politikat që kanë të bëjnë me të drejtat e grave dhe të rinjve, barazinë sociale, bashkëjetesën ndëretnike, mjedisin, përfshirë edhe puna e përbashkët në kuadër të Fondit Sovran.

Drejtori i Fondacionit, Rene Schlee u shpreh i kënaqur për bashkëpunimin që ka pasur, duke theksuar se edhe në pozitën e tij të re do ta ndjekë temën e përbashkët për forcimin e demokracisë sociale dhe forcimin e shkëmbimit ndërmjet socialdemokratëve.

Në përmbyllje të takimit, kryeministri i uroi Schlee suksese në pozitën e tij të re.



# Gërxhaliu: Nga funksionalizimi i Byrosë për konfiskimin e pasurisë më së shumti do të goditet diaspora



PRISHTINË, 25 GUSHT- Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu, ka thënë se nga funksionalizimi i Byrosë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustifikueshme do të goditet më së shumti diaspora.

Ai është shprehur se çdo eksperiment me sistemin e drejtësisë mund të ketë pasoja negative te shoqëria dhe shteti.

"Nga funksionalizimi i Byrosë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustifikueshme do të goditet më së shumti diaspora. Çdo eksperiment me sistemin e drejtësisë mund të ketë pasoja negative te shoqëria dhe shteti. Kjo vjen në shprehje sidomos kur mungon dialogu i mirëfilltë në mes të akterëve relevantë brenda një shteti", ka shkruar Gërxhaliu në "Facebook".

Ai ka theksuar se kur ligjet bëhen me tendencë për interesa partiake e jo në funksion të shtetit, pasojat mund të jenë të dëmshme.

Gërxhaliu ka thënë se Byroja Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustifikueshme dhe funksionalizimi i saj me ketë formë siç po prezantohet dhe në këtë kohë do të jetë një goditje direkte për diasporën dhe mërgimtarët. "Kontributi i diasporës është i pakontestuar dhe në këtë drejtim duhet kuptohet e vërteta se përmes bankave dhe institucioneve financiare dërgohet një pjesë e madhe për Kosovën, por pjesa më e madhe e parave nga diaspora vijnë gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë që është trefishi i asaj që dërgohet në forma bankare. Kemi një diasporë punëtore e cila punon shumë jashtë orarit të punës dhe ndoshta nga dy punë vetëm për qëllimin e ndihmesë dhe investimeve në Kosovë. Investimet më të mëdha të diasporës janë në patundshmëri dhe është një pjesë e parave ndoshta mund edhe të jetë fituar jashtë orarit të punës. Të gjitha këto që i thashë më lart mund të kenë efekte negative në qoftë se kërkohet deklarimi i origjinës së parave ku diasporës mund t'i verifikohen edhe paratë nga organet e shtetit ku veprojnë dhe jetojnë", ka deklaruar Gërxhaliu.

## Presidentja Osmani vizitë zyrtare në Shqipëri më 4 e 5 shtator

Prishtinë, 25 gusht- Presidentja e Kosovës Vjosa Osmani do të zhvillojë një vizitë zyrtare në Shqipëri më 4 e 5 shtator. Osmani do të qëndrojë në Shqipëri me ftesë të presidentit Bajram Begaj dhe do të pritet me ceremoni zyrtare. "Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Sh.T.Z. Bajram Begaj, do të presë me ftesë të tij për një vizitë shtetërore në Tiranë presidenten e Republikës së Kosovës, Sh.S.Znj. Vjosa Osmani. Vizita do të zhvillohet në datat 4-5 shtator 2023", ka njoftuar Presidenca e Shqipërisë.



# Komunat e dërgojnë në Kushtetuese Ligjin për Tatimin në Pronë




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 GUSHT - Asociacioni i Komunave të Kosovës, të premten, e ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese Ligjin për Tatimin në Pronë.
Dorëzimin e kërkesës për vlerësimin e ligjshmërisë së këtij ligji e bënë drejtori i AKK-së, Sazan Ibrahimi dhe kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj.
Asociacioni i Komunave të Kosovës, më 23 gusht paralajmëroi dërgimin e Ligjit në fjalë në Gjykatën Kushtetuese.
Në njoftimin e publikuar nga AKK thuhej ndër të tjera se Ministria e Financave mori vendim që ta ndryshoj Ligjin mbi Tatimin në Pronën e Paluajtshme pa e konsultuar fare Komunat e Kosovës.
Sipas Asociacionit të Komunave të Kosovës me miratimin e Ligjit në fjalë Komunat e Kosovës do të humbasim me dhjetëra miliona euro.
Në anën tjetër si absurditet dhe lojë të komunave e cilësoi ministri i Financave, Hekuran Murati, paralajmërimin për të dërguar Ligjin për Tatimin në Pronën në Gjykatën Kushtetuese.
Sipas tij, ky Asociacioni i dominuar nga partitë opozitare, "ka një lloj hipokrizie në vetvete". "Është vetëm lojë e disa prej komunave në këtë rast edhe e Asociacionit, që në njërën anë pretendojnë se kanë hallin e qytetarëve dhe kërkojnë të ulet barra për qytetarin e kur Qeveria bën hap të tillë e kundërshtojnë pastaj. Duket absurde edhe dërgimi në Kushtetuese sepse Qeveria s'ka asnjë ndërhyrje në këtë aspekt. Përkundrazi, e gjithë vendimmarrja është në nivel komunal", ka thënë Murati.
Murati në një konferencë për media pas mbledhjes së Qeverisë së Kosovës, ka thënë se komunat kanë afat deri më 16 shtator të marrin vendim për zbritjen dhe se gjithçka është në përgjegjësinë e kuvendeve komunale. "Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Komunat apo kuvendet komunale e kanë të domosdoshme të marrin vendime 30 ditë pas hyrjes në fuqi, data e fundit pra 16 shtator. Pra tash u takon kuvendeve komunale që deri më 16 shtator ta miratojnë zbritjen për qytetarët e secilës komunë. Kjo po ashtu përkon me afatin e këstit të dytë, që është 30 shtator. Pra më 16 shtator secili qytetar mund ta dijë sa prej tatimit në pronë do t'u falet nga komuna e tyre. Kjo tashmë ekziston dhe ka bazë ligjore për të. Duhet të merret vendimi nga komunat", ka deklaruar ai.
Asociacioni i Komunave të Kosovës u arsyetua se me miratimin e Ligjit në fjalë Komunat e Kosovës do të humbasim me dhjetëra miliona euro, por sipas ministrit Murati komunat s'mund të ankohen për dëmtime të buxhetit, pasi sipas tij, tashmë kanë të hyra deri në gusht, aq sa kishin tërë vitin e shkuar. "Sa i përket asaj se a dëmtohet buxheti, po ashtu deri më 22 gusht ishin 32 milionë euro të hyra të komunave. Tërë vitin e kaluar kanë qenë 34.5 milionë euro. Në gusht, ende pa përfunduar muaji, jemi në nivelin e tërë vitit të kaluar. S'mund të flitet për dëmtim të buxhetit komunal sepse tashmë kanë mbledhur e që besoj se deri në fund të gushtit do ta kalojnë tërë vitin e kaluar. Çfarëdo falje që bëhet e këstit të dytë nuk e dëmton buxhetin e komunave, sepse vetë kanë thënë që u janë rritur të hyrat. Pasi që për disa qytetarë ka pasur rritje të vlerësimit të pronës, rrjedhimisht edhe e faturës, kanë pasur edhe komunat rritje më shumë. Pra përtej asaj që kanë pritur", ka shpjeguar ai.

## Ligji për Tatimin në Pronë në Kushtetuese, Murati: Veprim i kotë

Ndaj këtij veprimi ka reaguar të premten sërish ministri i Financave, Hekuran Murati, duke e quajtur veprim të kotë.
Ai ka thënë se krejt çka po duan të bëjnë me këtë potez kasta e vjetër politike, është që të fshihen prapa Gjykatës Kushtetuese. "Për ligjin që e kishin miratuar vetë më 2018, ligj i cili parashihte vlerësimin e pronave sipas tregut, dhe që parashihte që përveç tatimit në objekte, të fillonte edhe të llogaritej tatimi në tokë me 100% të vlerës në vitin 2023, tentuan t'ia hedhin fajin qeverisë sonë. Thanë se qytetarit po i vihej barrë e papërballueshme, dhe se po të ishte në dorën e tyre, do ta lehtësonin këtë barrë. Qeveria Kurti e bëri këtë të mundur duke miratuar ndryshimin e Ligjit për Tatim në Pronë, ashtu që secila komunë të kishte mundësinë të falte faturat deri në 100 euro për vitin 2023, për të gjithë tatimpaguesit", ka shkruar Murati në "Facebook".
Ai ka shtuat tutje: "Dhe, çfarë bëjnë tash ata që para 6 muajsh 'qanin hallin e qytetarëve'? E dërgojnë ligjin në Gjykatë Kushtetuese. Pra, po dëshmohet edhe njëherë që britmat këta nuk i kanë as për qytetarin e as për shtetin. Sidoqoftë, edhe ky veprim i tyre është i kotë. Krejt çka po duan të bëjnë me këtë potez kasta e vjetër politike, është që të fshihen prapa Gjykatës Kushtetuese, se gjoja ata 'do ta kishin miratuar zbritjen e tatimit, por ja që ligji është bllokuar në Gjykatë Kushtetuese'. Por kjo nuk pi ujë. Sepse ligji i ndryshuar tashmë është në fuqi, dhe secila komunë ka mundësinë të vendosë për faljen ose jo të një pjese të tatimit në pronë për të gjithë tatimpaguesit më së largu me 15 shtator 2023", ka reaguar ministri Murati.

## Avokati Halimi: Ridvan Muharremi është takuar me Rozeta Hajdarin në zyrën e saj

PRISHTINË, 25 GUSHT- Mahmut Halimi, avokati i afaristit Ridvan Muharremit i cili është arrestuar nën dyshime për keqpërdorime të rezervave shtetërore, ka thënë se klienti i tij është takuar me ministren Rozeta Hajdari në zyrën e saj në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT).
Halimi në "Debat Plus" në RTV Dukagjini tha se Ridvan Muharremit i është kërkuar ndihmë për sigurimin e rezervave shtetërore nga vetë ministrja Rozeta Hajdari. "Është ftuar nga Ministria, i ka pyet me kënd je duke folur, ka thënë kur të vish në ministri lajmërohesh në recepsion pastaj takohemi, drejt në zyrën e Rozeta Hajdarit, aty kanë qenë zyrtarë të lartë të ministrisë, ka qenë edhe ministrja aty. Edhe Ridvani e ka cekë që për herë të parë Hajdarin e kam taku në zyrën e saj", ka theksuar ai.
Avokati Halimi ka thënë se nga Muharremi, ministrja Hajdari ka kërkuar të gjejë treg për të siguruar vaj dhe sheqer. "Kanë kërkuar nga ai të shikoj të gjej treg të vajit dhe sheqerit, ka thënë se do të interesohet dhe do t'i lajmërojë shumë shpejt. Është përshirë për të kontribuuar", ka thënë ai.
Halimi ka pohuar se klienti i tij nuk ka pasur marrëdhënie kontraktuale me MINT-in, derisa shtoi se nënshkrimi i tij nuk gjendet në asnjë dokument.



# Prigozhin, misteri i orëve të fundit



Të shtunën, më 24 qershor, Yevgeny Prigozhin regjistron një video në të cilën thotë se ka marrë kontrollin e komandave ushtarake të Rostov-on-Don, bazës kryesore logjistike ruse për luftën në Ukrainë. "Bombardimet e pozicioneve të armikut dhe ato mjekësore vazhdojnë sipas planit, tani do të ndalen vetëm ato kundër bazave tona". Udhëheqësi mercenar pretendon se hierarkitë ushtarake të shtetit rus po bombardojnë "heronjtë që pushtuan Bakhmutin".

Shtatë e mëngjesit, zë i vendosur, është një këmbanë alarmi tronditëse. Rusia e gjen veten të copëtuar. Prigozhin është i papërmbajtshëm, ai shpjegon se "ata donin të na vrisnin" dhe tani "ne do të jemi ata që do të marshojmë drejt Moskës për të rivendosur drejtësinë". Duket si një grusht shteti, por është fillimi i fundit për "kuzhinierin e Putinit", i cili është bërë miliarder dhe hero lufte përmes masakrave.

Vetëm pesë ditë më vonë, me marshimin që mbërriti 200 kilometra larg Moskës dhe u ndërpre papritmas, Prigozhin është tashmë përballë Putinit, njeriu të cilit i detyrohet gjithçka që zotëron dhe të cilin, megjithatë, e tradhtoi në mënyrë kaq flagrante.

Rebeli vjen nga Bjellorusia. Presidenti-diktator Lukashenko thotë se e bindi të ndalojë kryengritjen "në mënyrë që të mos shtypet si një insekt". 34 udhëheqësit e tjerë ushtarakë të milicisë private Wagner udhëtojnë në rrugë të ndryshme, por të gjithë priten në Kremlin nga vetë Vladimir Putini. Për atë që ata thanë dihet pak. Zëdhënësi presidencial Dmitry Peskov raportoi tre orë bisedime. Komandantët e Wagnerit "nënvizuan se ata janë ushtarë besnikë të kreut të shtetit dhe komandantit suprem". Që do të thotë gjithmonë i njëjti person: Putin. As në atë rast Prigozhin nuk pranoi të hiqte dorë ose të tregonte pendesë. Ai njeh autoritetin e Carit, por jo atë të gjeneralëve të tij apo të Ministrit të Mbrojtjes. Për muaj të tërë i quajti "të paaftë", "të privilegjuar", përballë gjithë vendit. Nëse do të kishte pasur një mundësi të shpëtonte veten, Prigozhin e hodhi poshtë atë ditë. Putini kishte qenë i qartë pas grushtit të shtetit: "Ishte një tradhti, një thikë pas shpine".

Mirëpo, që nga fundi i qershorit, sipërmarrësi i dhunës ka kaluar nën tokë, është zhdukur nga rrjetet sociale. Thuhet se ndodhej në mërgim në Bjellorusi, por që më 6 korrik Presidenti Lukashenko njoftoi se "për momentin është në Shën Petersburg ose në Moskë, ose diku tjetër". Puçisti i dështuar duket i lirë të lëvizë pikërisht në vendin që donte të destabilizonte. Vetë "marshimi drejt Moskës" vihet në pikëpyetje. Si ka mundësi që ka qenë një grusht shteti i vërtetë nëse fajtori është i lirë?

Prigozhin raportohet se ndodhet në Afrikë, pastaj përsëri në Rusi, sigurisht që nuk ndodhet në shtëpi kur vila e tij në Shën Petersburg kontrollohet në fillim të korrikut. Ata gjejnë mjekra dhe dokumente false, shufra floriri, armë dhe uniforma me gjokset plot medalje. "Është një përpjekje e liderëve rusë për të diskredituar "babain" – reagon Wagner –. Në fund të fundit, shufrat e gjetura nuk janë edhe aq shumë për një njeri të pasur si Yevgeny». Nuk e ul kokën, Prigozhin.

Në fund të korrikut, Pentagoni sugjeron se ai po përdor sozi për të ngatërruar ata që do të donin ta përgjonin. Financial Times ndjek dy avionët e tij brazilianë në Flightradar. Sipas Bellingcat, ai shpesh ndryshon aeroplanin në minutën e fundit, në mënyrë që të mos dihet se me cilin po fluturon. Udhëheqësi mercenar u beson njerëzve dhe inteligjencës së tij. I pari në fakt vdiq për të, i dyti ka dështuar dje.

Të hënën Prigozhin rishfaqet në një video gjithmonë paradoksale dhe provokuese: «Jemi në punë. Temperatura është mbi 50 gradë. Kjo është gjithçka që na pëlqen. Grupi Wagner po e bën Rusinë edhe më të madhe. Drejtësi dhe lumturi për afrikanët". Gëzimi i fundit para fluturimit të mbrëmjes së djeshme nga Moska. / bota.al




Sport


Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

# Prishtina synon ta njofton Malishevën me humbje




EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 25 GUSHT - Dy ndeshje do të zhvillohet sot (e shtunë) e dy tjera zhvillohen nesër (e diele) në kuadër të javës së tretë në Superligën e Kosovës në futboll. Ndërsa ndeshja e pestë mes Dritës dhe Ballkanit është shtyrë për shkak të pjesëmarrës së kampiones në fuqi në garat evropiane. Prishtina e treta në tabelë me një fitore dhe një barazim e pret skuadrën në top formë, Malishevën. Kjo e fundit në dy ndeshje ka regjistruar dy fitoren dhe synim e ka që edhe ndaj kryeqytetasve ta ruaj formën e mirë, pse jo të arkëton edhe pikët e plota. Në ndeshjen tjetër Feronikeli '74 i rikthyer në Superligë e pret Gjilanin nga i cilin takim synon pikët e para në këtë edicion të elitës. Në anën tjetër Gjilani pas problemeve financiare disi e ka marrë vetën dhe k filluar garat dhe në ndeshjen e parë mori barazim ndaj Prishtinës. Ndeshje interesante zhvillohet edhe të dielën në Klinë ku Dukagjini kërkon pikët e para në përballje me klubin me traditë të madhe në futbollin e Kosovës, Lirinë. Prizrenasit në dy ndeshjet e para kanë regjistruar një humbje e një barazim. Në ndeshjen tjetër Fushë-Kosobva e pret skuadrën e Llapit. Favorit në letër janë djelmoshat e Tahir Batatinës, por "Pampurat" do të kërkojë rezultat pozitiv. Ndeshja e pestë e kësaj xhiro dhe derbi mes Dritës dhe Ballkanit është shtyrë për shkak se kampionët në fuqi bëjnë gara në Ligën e Konferencës, ku duhet theksuar se në ndeshjen e parë të "play-off"-it kanë shënuar fitore ndaj BATE Borisov me rezultat 4-1.

*SUPERLIGA /Java e tretë*

*Të shtunën takohen:*
*16:00 Prishtina - Malisheva*
*16:00 Feronikeli '74 - Gjilani*

*Të dielën takohen:*
*Fushë Kosova - Llapi*
*16:00 Dukagjini - Liria*
*16:00 Drita - Ballkani (është shtyrë)*

## SHKURT

### Edvin Kuç: Jam i gatshëm të 'vdes' për Ballkanin

FC Ballkani ka shënuar fitore në ndeshjen e parë të "play-off"-it të Ligës së Konferencës. Kampioni i Kosovës mposhti Bate Borisovin në "Fadil Vokrri" me rezultat bindës 4-1. Dy gola nga Bleart Tolaj dhe nga një gol i Bajram Jashanicës e Armend Thaqit i dhanë fitoren skuadrës së Ballkanit. Pas ndeshjes për mikrofonat e "SuperSport" foli edhe kapiteni i Ballkanit, Edvin Kuç, i cili edhe pse i lënduar luajti deri në fund të ndeshjes. "Urime Kosova, për të gjithë që e duan Ballkanin. Nuk është e lehtë të ndërrohet formacioni, kishim lojtarë të rinj, por prapë kemi treguar karakterin që e kemi. Sinqerisht për këtë grup mundem edhe me 'vdes' e jo të luaj futboll, falënderoj stafin që unë munda të vazhdoj lojën", ka deklaruar Kuç për "SuperSport".

### Zeneli largohet nga Reimsi, transferohet te Adana Demirspor

Ylli i Kosovës, Arbër Zeneli është bërë me skuadër të re sipas lajmeve të fundit që vijnë nga Turqia. Siç bëhet e ditur nga gazetari turk, Yagiz Sabuncuoglu, skuadra e Adana Demirspor e ka transferuar Arbër Zenelin. Zeneli i është bashkuar Adana Demirsporit nga skuadra franceze Reims, ku kaloi pesë sezone. Ylli kosovar nuk po ka minutazh të kënaqshme te Reims dhe ka pranuar largimin nga klubi francez për t'iu bashkuar Superligës së Turqisë. Sezonin e kaluar, Zeneli arriti të bëjë 26 paraqitje në të gjitha garat me Reims, duke regjistruar një gol dhe katër asistime mbi emrin e tij. Ndërkaq, gjatë karrierës së tij si lojtar i Reims, Zeneli ka arritur të regjistrojë nëntë gola dhe 14 asistime mbi emrin e tij.

### Ronaldo vjen me përshëndetjen islame 'Selamun Aleykum'

Cristiano Ronaldo u transferua në fillim të këtij viti në Arabinë Saudite, duke i dhënë fund eksperiencës së gjatë dhe të suksesshme në Evropë. Ylli portugez i përket fesë së krishterë, por kohë pas kohe ka bërë veprime me të cilat u ka pëlqyer vendësve, të cilët i përkasin fesë islame. Para disa javësh, 38-vjeçari kishte rënë në sexhde, duke e festuar në këtë mënyrë një gol të tij. Ndërsa, tash pesë herë fituesi i "Topit të Artë" shfaqet në një video duke përshëndetur me përshëndetjen islame "Selamun Aleykum". Natyrisht, edhe ky veprim i kampionit të Evropës me Portugalinë do t'ju pëlqejë myslimanëve.

## Emërllahu operohet me sukses, Ballkani ia dedikon atij fitoren

Suharekë, 25 gusht - Mesfushori i Ballkanit, Lindon Emërllahu është operuar me sukses pas lëndimit që pësoi kohë më parë. Lajmin e ka konfirmuar klubi suharekas me anë të njoftimi në faqen zyrtare. Ballkani fitoren e madhe 4-1 kundër BATE Borisov ia dedikoi Emërllahut. "Fitorja e djeshme i dedikohet diamantit të klubit tonë Lindon Emërllahut , i cili pas një lëndimi gjatë ndeshjes kundër FC Larne , është detyruar të kryej një operacion në gjurin e djathtë. Operacioni është kryer me sukses dhe Lindonit i dëshirojmë rikthim sa më të shpejtë. Ashtu siç ka fituar në fushën e blertë, do t'ia del mbarë edhe ndaj lëndimit, sepse Lindoni është kampion i lindur dhe i disiplinuar ndaj punës dhe detyrës, e në veçanti të udhëzimeve të mjekut", thuhet në njoftimin e Ballkanit.



## Rubiales: Po më bëjnë shumë presion, por nuk jap dorëheqjen



Madrid, 25 gusht - Luis Rubiales ka refuzuar të largohet nga posti i presidentit të Federatës Spanjolle të Futbollit për veprimet e tij pas finales së Kupës së Botës për femra të dielën. 46-vjeçari puthi në buzë sulmuesen Jenni Hermoso pas fitores 1-0 të Spanjës ndaj Anglisë. Rubiales kërkoi falje për puthjen të hënën përpara se FIFA, organi drejtues i futbollit botëror, të hapte procedimin disiplinor kundër tij të enjten. "Më kanë thënë se gjëja më e mirë është që unë jap dorëheqjen. Duhet të ketë ndonjë arsye që të të nxjerrin nga një vend Kush më njeh e di që do të qëndroj deri në fund. Ka ardhur koha të them diçka. Mendoni se është një arsye për të vuajtur sulmet ndaj meje? A është mjaft serioze që unë të largohem? Nuk do të jap dorëheqjen!", ka deklaruar Rubiales.

# Ramadani: Serie A e kisha ëndërr fëmijërie



Lecce, 25 gusht - Ylber Ramadani përmbushi ëndrrën e tij të fëmijërisë. Mesfushori shqiptar debutoi në Serie A me fanellën e Lecces. Lojtari 27-vjeçar ka treguar për "Daily Record" se nuk mund ta refuzonte ofertën nga klubi italian dhe menjëherë ia bëri të ditur drejtueseve të Aberdeenit se Serie A ishte ëndrra e tij. Ramadani nuk nguron të falënderoj klubin skocez, që e bëri të ndihet si në shtëpi dhe më pas i dha shansin të provonte veten në një nga ligat më të forta të Evropës. "Është një hap i madh për mua dhe më duhej ta bëja. Kur isha fëmijë, gjithmonë ëndërroja të luaja në një nga ligat më të mira në botë. Serie A është liga e dytë më e mirë në botë dhe për mua është një ëndërr e realizuar. I thashë babait tim që jam larguar nga shtëpia për 12 vjet dhe gjithmonë i kam thënë se do t'ia dilja. Kështu, kur lindi mundësia, më duhej t'i tregoja Dave Cormack (kryetar), Alan Burrows (shefi ekzekutiv) dhe Steven Gunn (drejtor sportiv) se duhej të lëvizja, sepse të luaja në Serinë A është ëndrra ime. Më duhet të falënderoj Aberdeenin, sepse më dhanë këtë mundësi dhe lejuan që kjo të ndodhte", ka deklaruar Ramadani.

# Verstappen: Pistën në Holandë e kam më speciale, dua fitore



Zandvoort, 25 gusht - Formula 1 rikthehet këtë fundjavë në pistën e Zandvoort, në Holandë, aty ku dy herë kampioni i botës Max Verstappen, synon të festojë para publikut të tij. holandezi synon të arrijë fitoren e 9-të radhazi me Red Bull, duke barazuar rekordin e Sebastian Vettel, të 10 viteve më parë. "Gjatë pushimeve kam pushuar me familjen time. Hoqa totalisht mendjen nga Formula 1, fjeta mjaftueshëm dhe ndihem gati për të garuar sërish. Do të garoj në shtëpinë time, ndaj për mua kjo është një fundjavë e rëndësishme. Dua të vijoj në këtë rrugë që kam nisur, por në këtë sport nuk ka asgjë të sigurt", ka thënë Verstappen. "Dua të vazhdoj nga aty ku e lamë një muaj më parë, duke mos lejuar ulje të përqendrimit. Çdo vit, është e mrekullueshme të shohësh kaq shumë tifozë, ndërkohë që është një pistë që e adhuroj. E dimë që kemi një makinë të shpejtë, por duhet të jem të aftë të bashkojmë disa faktorë në një komponent të vetëm", ka shtuar piloti holandez. "Objektivi është i qartë, fitorja. Sidomos këtu në Holandë. Nuk mendoj shumë për rekordin e 9 fitoreve radhazi, pasi duhet punuar që të kemi një makinë të balancuar mirë. Këtë vit po dominojmë, gjë që ndodh një apo dy herë në karrierë, por do të më pëlqente më shumë rivalitet", ka pohuar Verstappen.

## SHKURT

### Kroos: Xhaka do të marrë më së shumti kartonë të kuq në Bundesligë

Granit Xhaka gjatë kësaj vere bëri lëvizjen e tij nga Arsenali te Bayer Leverkuseni dhe edicionin në Bundesliga e nisi mirë. Ai me Leverkusenin triumfuan 3-2 kundër Leipzig, skuadrën që triumfoi në Superkupën gjermane jo shumë kohë më parë ndaj Bayern Munchen. Mesfushori shqiptar, Granit Xhaka ka marrë një vlerësim interesant nga mesfushori gjerman i Real Madridit, Toni Kroos. Ky i fundit ka parashikuar Xhakën si futbollistin më të ndëshkuar me kartonë të kuq këtë edicion në elitën e futbollit gjerman. "Graniti Xhaka padyshim se do të marrë më së shumti kartonë të kuq në Bundesligë. Unë e shoh atë një lojtar shumë të mirë. Por ai është gjithashtu një kokëfortë dhe kjo mund të ndodhë", ka thënë Kroos. 30-vjeçari nga Prishtina u transferua te Leverkusen për 15 milionë euro nga Arsenali. Xhaka ka nënshkruar kontratë deri në vitin 2028 me Bayer Leverkusenin.

### Një klub shqiptar shpreh interesim për Greenwoodin

Një klub shqiptar raportohet se ka shprehur interesim për të nënshkruar me futbollistin Mason Greenwood. "TalkSport" raporton se emri i klubit nuk është bërë i ditur. Mason Greenwood është lojtar i lirë, pasi është liruar nga kontrata me Manchester United. Ai pati probleme me ligjin një kohë të gjatë, duke mbetur larg fushave të blerta. 21-vjeçari u arrestua me dyshimin për përdhunim, sulm dhe kërcënime për vrasje në janar 2022. Akuzat u hoqën nga prokuroria në shkurt të këtij viti.

### Italia dhe Mali i Zi e nisin mbarë Botërorin

Italia e ka mposhtur Angolën në ndeshjen e parë në Kampionatin Botëror. Italianët shënuan fitore me rezultat 81-67, kështu duke e nisur mbarë garën. Më i dalluari në fitoren e Italisë, ishte Simone Fontecchio, me 19 pikë, pesë kërcime dhe dy asistime. Kombëtarja italiane në takimin tjetër përballet me Republikën Dominikane. Mali i Zi, ka shënuar fitoren e parë në Kampionatin Botëror, që nisi nga sot. Kombëtarja malazeze në grupin D mposhti atë të Meksikës me rezultat 91-71. Më i dalluari në ndeshje ishte Nikola Vuçeviq, me 27 pikë, 10 kërcime dhe një asistim. Mali i Zi në ballafaqimin tjetër ndeshet me Egjiptin.

### Klopp: Nuk e shesim Salahun

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, ka bërë të ditur se Mohamed Salah nuk do të largohet, pasi nuk është në shitje. Kloppi, në një konferencë për shtyp ka thënë do t'i refuzojnë ofertat për egjiptianin. "Al Itihhad? Ne nuk kemi asnjë ofertë – Mo Salah është një lojtar i Liverpoolit, dhe për të gjitha gjërat që bëjmë është thelbësorë. Nëse do të kishte diçka, përgjigjja do të ishte JO", u shpreh Klopp. "Mo është 100 për qind i përqendruar te Liverpooli. Asgjë për të komentuar për këtë, ai është lojtari ynë dhe kështu s'kam çfarë të them". Është raportuar se një klub nga Arabia Saudite ka ofruar 100 milionë euro për egjiptianin, por deri më tani këto spekulime nuk janë konfirmuar si nga lojtari ashtu edhe nga klubi në fjalë.

## Arsenali nis fushatën e spastrimit, 9 lojtarë në shitje

Arsenali, pasi ka mbyllur fushatën e blerjeve, ka nisur punën për të larguar lojtarët që janë të tepërt. Sipas mediave britanike, janë 9 të tillë që pritet të lënë Londrën gjatë ditëve të mbetura të merkatos së verës. Në listën e lojtarëve që janë me valixhen gati përfshihen emrat e Folarin Balogun, Gabriel Magalhaes, Kieran Tierney, Takehiro Tomiyasu, Sambi Lokonga, Rob Holding, Cedric Soares,
Nicolas Pepe dhe Nuno Tavares. Klubi londinez është në pritje të ofertave të kënaqshme, që do të balanconin disi bilancin pas shpenzimeve të mëdha që janë bërë këtë verë. Për momentin, i vetmi që ka oferta të mira është Balogun, që kërkohet nga Monaco dhe Chelsea. Sipas trajnerit Mikel Arteta, këta lojtarë mund të lënë klubin, që po përpiqet të gjejë një sistemim për ta, duke i shitur apo dërguar në skuadra të tjera në formë huazimi.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria –Vlada-Government*
*MINISTRIA E ARSIMIT,SHKENCES, TEKNOLOGJISËDHE INOVACIONIT*
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
*AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE*
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 682 /1
Dt. 25.08.2023

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017, Udhëzimi Administrativ 05/2021 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

## SHPALLJE E KONKURSIT

**Për plotësimin e vendit të lirë në Qendre e Kompetencës "11 Marsi", në Prizren për vitin shkollor 2023/2024**

| Niveli | Institucioni/Shkolla | Vendi | Pozita/Vend i ilirë | Vendi lirë/ Zëvendësim |
|---|---|---|---|---|
| QK | Qendra e Kompetencës "11 Marsi" | Prizren | Një mësimdhënës/e për lëndët profesionale në profilin e Dizajnit Softuerik | Deri më 31.08.2024 |
| QK | Qendra e Kompetencës "11 Marsi" | Prizren | Një mësimdhënës/e për lëndën e Matematikës - me normë të plotë | Deri më 31.08.2024 |
| QK | Qendra e Kompetencës "11 Marsi" | Prizren | Një mësimdhënës/e për lëndën e Edukatës Fizike - me normë të plotë, për mësim në gjuhën boshnjake | Deri më 31.08.2024 |
| QK | Qendra e Kompetencës "11 Marsi" | Prizren | Një Instruktor/e për profilin e Arkitekturës – me normë të plote | Deri më 31.08.2024 |

**Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;**

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin ne fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore tënxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon nëmënyrën e duhur ndaj tyre,duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

**Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:**

- Diploma e përgatitjes profesionale përkatës sipas UA (MAShTI), niveli i 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës së punës në arsim (nëse ka);
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

**Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktor:**

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e teorisë dhe praktikes profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikes profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin ne fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

**Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për instruktor:**

- Diploma e përgatitjes profesionale përkatës sipas UA (MAShTI), niveli i 6 sipas KKK;
- Instruktor profesional me kualifikim: post sekondar, arsim të mesëm të lart;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës së punës;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

- **Procedurat e konkurrimit:**

- Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës "11 Marsi" në Prizren.
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
- Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria –Vlada-Government*
***MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË***
**AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR**
***AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE***
**AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION**

**Nr. 677/1** **Datë: 25.08.2023**

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017, Vendimi (MASHTI) nr. 01B/027 të dt. 03.03.2023, Vendimi (MAShTI) nr. 326/01B të dt. 28.07.2022, si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur njofton:

## NJOFTIM

Njoftohen të gjithë kandidatët të cilët kanë aplikuar në konkursin e ri-shpallur me nr. 651/1 të dt. 17.08.2023 për pozitën një (1) Instruktor /e për modulet profesionale të profilit "Esteticient/e", 10 orë dhe një (1) Instruktor /e për modulet profesionale të profilit "Floktari", 10 orë në Qendrën e Kompetencës në Prizren. Se ky konkurs anulohet.

Kuzhina Qendrore

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
LOCAL PUBLIC ENTERPRISE
NPL "KUZHINA QENDRORE" SH.A.
PRISHTINË
Nr. 0289 Dt. 25.08.2023

Ndërmarrje publike lokale | Rr. Egnatia p.n. - 10 000 Prishtinë | www.kuzhina.net | kuzhinaqendrore@gmail.com | tel: + 383 45 709 106

Në bazë të nenit 16.2 dhe 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë: viti III/nr. 31/15 Qershor 2008), si dhe në bazë të nenit 6 të Ligjit nr. 05/L-009 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/l-087 për ndërmarrjet publike i ndryshuar dhe i plotësuar më ligjin nr. 04/l-111 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 10 / 07 maj 2015) Komisioni Komunal i Aksionarëve të **N.P.L. KUZHINA QENDRORE SH.A.** në Prishtinë, me datën 25.08.2023, shpall këtë:

## KONKURS

**Pozita:** Një (1) Anëtare të Bordit të Drejtorëve të **N.P.L. KUZHINA QENDRORE SH.A.** në Prishtinë ( nga gjinia femërore për shkak të përmbushjes së kuotës gjinore në pajtim me legjislacionin në fuqi).

**I përgjigjet:** Komisionit Komunal të Aksionarëve të **N.P.L. KUZHINA QENDRORE SH.A.** në Prishtinë.

**Mandati:** Tri (3) vite.

**Kompensimi:** Konform nenit 20 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087, dhe plotësim ndryshimeve përkatëse.

**1. Të përgjithshme**

Kandidatja për këtë vend pune duhet të jetë person me integritet, e cila i plotëson kushtet e kualifikimit dhe kriteret e pavarësisë, posedon përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar, si dhe i plotëson kushtet tjera të kërkuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe aktet tjera pozitive relevante.

**2.Kushtet e kualifikimit profesional dhe përshtatshmërisë**

Çdo kandidatë për t'u konsideruar në pozitën e Drejtorit të Bordit, duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvoje - së paku në një nivel të lartë të menaxhmentit në fushat si vijon: në administrim të biznesit; - financa të korporatave; - financa; - menaxhim thesari; - banka; - konsulencë në biznes ose industri; ose - nga një fushë tjetër e shkencës ose njohurisë e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste - të ndërmarrjes; ose për së paku pesë (5) vite, të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtar- i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlidhet ngushtë me veprimtarinë afariste të NP-së.

**3.Papajtueshmëria**

Konform ligjit në fuqi, një person nuk ka të drejtë të shërbejë si drejtor në Bordin e Ndërmarrjeve publike, nëse: a) Ka qene i/e dënuar nga një gjykatë kompetente, përveq nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë tjetër në bazë të ankesës; ka kryer vepër penale ose civile, vepër që përfshinë pergenjështrimin, prezantimin e rrejshëm, korrupsionin, vjedhje, pastrimin e parave, përvetësimin, keqpërdorimin apo ndarjen e rrejshme të fondeve; ka qenë i/e përfshire në mitosje apo ryshfet sipas ligjeve apo rregulloreve në fuqi në Kosove apo ndonjë vend tjetër, apo sipas traktateve ose konventave ndërkombetare; b) është vendosur nga një gjykatë ose organ apo organizatë përgjegjese për zbatimin e kodit etik apo standardeve të sjelljes profesionale, përveç nëse ky dënim ose vendim me pas është ndryshuar nga një gjykate ose organ tjetër në bazë të ankesës (i) se është angazhuar në sjellje jo profesionale, (ii) se ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, (iii) se ka keq përvetësuar apo ka keqperdorur parate apo burimet publike, (iv) se ka keqperdorur apo keq-përvetësuar informatat (të dhënat) e fituara gjatë shërbimit si zyrtar publik apo shërbyes civil, ose (v) se ka keqpërdorur postin publik ose postin në shërbimin civil për përfitime personale ose për përfitime apo përparësi të një të afërmi ose të njohuri; apo; c) ka bërë përgenjështrime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim apo betimi tjeter, ose dokumenti të vulosur apo noterizuar; dhe d) është shpallur i falimentuar gjatë dhjete (10) viteve të kaluara; e) punon në ndonje institucion ku bëhen politikat zhvillimore për Ndërmarrje Publike përkatëse ku kandidati punon.

**Te gjithë drejtorët duhet të jenë të pavarur. Nje person nuk konsiderohet i pavarur dhe nuk kualifikohet për zgjedhje si drejtor në një NP nëse:**

a) aktualisht është zyrtar ose menaxher i NP-së përkatëse ose cilësdo nga filialet e saj, ose ka shërbyer si zyrtar ose menaxher i NP-së përkatese ose cilësdo nga filialet e saj brenda pesë (5) viteve te kaluara;

b) aktualisht është punonjës i nivelit të lartë i NP-së përkatëse, ose ka shërbyer si punonjës i nivelit të larte në NP-në përkatëse brenda tri (3) viteve të kaluara;

c) aktualisht ka, ose gjatë tri viteve të kaluara ka pasur, çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (perveq; si konsumator individual i shërbimeve të NP-së) me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;

d) është aksionar, drejtor, zyrtar ose punonjës i larte në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik i cili ka marrëdhenie materiale afariste me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;

e) pranon, ose ka pranuar brenda tri (3) viteve të kaluara, kompensim shtesë nga NP përkatëse ose cilado nga filialet e saj (përveq; honorarit të Drejtorit ose kompensimit stimulues të përcaktuar në nenin 20.1 te ligjit primar, ose është anëtar në skemen pensionale të NP-së përkatëse ose cilësdo nga filialet e saj;

f) mban drejtorësi të ndërsjellë ose ka lidhje të konsiderueshme me drejtorët e tjerë të NP-së përkatese përmes përfshirjes në shoqëri tjera tregtare ose organe;

g) perfaqëson në aksionar i cili posedon dhjete përqind (10%) të aksioneve votuese në NP-në përkatëse;

h) ka shërbyes në Bordin e Drejtorëve të NP-së përkatëse me shumë se nëntë (9) vite nga data e zgjedhjes së parë të tij/saj; është i afërm i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e "Interesit Financiar" ne nenin 2 të ligjit primar i cilitdo person që i takon cilësdo nga kategoritë më sipër përveç personit të përcaktuar në pikën (b); ose

i) është ose (i) punonjës, zyrtar, drejtor ose aksionari, ose ka një Interes Financiar në, një shoqeri tregtare të pa-listuar dhe që konkurron me Ndermarrjen, ose (ii) menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy përqind (2%) të të drejtave të votimit) i, ose ka një Interes të konsiderueshëm Financiar në, cilëndo nga shoqërite tregtare të listuara që konkurrojnë me Ndërmarrjen; dhe

j) është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhes 36 muajsh para datës së aplikimit ka qenë (i) zyrtar i zgjedhur publik, (ii) i emëruar politik ose (iii) bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;

k) ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktonte që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutinore, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij fiduciare ndaj Aksionarëve dhe NP-së.

**4. Dokumentacioni i nevojshem.**

Kandidatët për drejtorë në Bordin e Drejtorëve konform këtij konkursi, duhet t'i dorezojnë dokumentet si më poshtë:

• Aplikacionin (merret në zyrën e ndërmarrjes ose në ëeb faqe të ndërmarrjes, ëëë.kuzhina.net)

• CV-në

• Letër motivimin

• Dëshmite mbi kualifikimin profesional të noterizuar (Diplomat/Çertifikatat dhe dokumente të ngjashme të marra jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara).

• Dëshmite mbi përvojen e punës e vërtetuar me trustin pensional (Aplikacioni duhet të ofroj të dhëna të sakta mbi periudhat e angazhimit dhe të korrespondojë me dokumentet vërtetuese).

• Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo me e vjetër se gjashtë muaj)

• Deklaratën nën betim (merret në zyret e ndërmarrjes, ose në ëeb faqe te ndërmarrjes).
Me këtë dokument kandidati deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësise dhe ato të përshtatshmërisë profesionale sipas paragrafëve 1-3 të nenit 17 të ligjit për ndërmarrjet publike nr. 03/L-087. Çdo përgënjeshtrim material - qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca - ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm dhe, nëse është e aplikueshme, largimin e personit.

• Kopjen e letërnjoftimit

• Lista kontrolluese (merret në zyrën e ndërmarrjes, ose në ëeb faqe të ndërmarrjes).

**5. Informata për procedurën e konkurrimit.**

Konkursi do të jetë i hapur nga data 25.08.2023 deri me datën 09.09.2023: Dokumentacioni i aplikantëve mund të dorëzohet në arkivin e N.P.L. KUZHINA QENDRORE SH.A. në Prishtinë, çdo ditë pune prej ores 8:00 - 16:00, ose nëpërmjet postes fizike; (në zarf të mbyllur) të adresuar: Për Komisionin Komunal të Aksionarëve të **N.P.L. KUZHINA QENDRORE SH.A.** në Prishtinë - "Aplikacion për Drejtor Bordi".

Të gjitha dokumentet të paraqiten në kopje të noterizuara, ndërsa origjinali i tyre, do të kërkohet në fazat e më vonshme të përzgjedhjes. Informatat shtesë mund të sigurohen përmes e-mail adresës: kuzhinaqendrore@gmail.com. ose drejtpërdrejtë në arkivin e Ndërmarrjes. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren parasysh. Të gjithë formularët duhet plotësuar në tërësi, mos plotësimi i tyre dhe informatat e pasakta do të rezultojnë ne diskualifikimin e menjëhershëm dhe, nëse është e aplikueshme, largimin e personit.

Komisioni Komunal i Aksionarëve do të zhvilloj një procedurë të hapur /transparente dhe konkurruese, ku përzgjedhja do të bëhet ekskluzivisht në bazë të meritës, konform Ligjit në fuqi dhe pa asnjë lloj diskriminimi, për çka inkurajon në aplikim kandidatët:

- nga gjinia femerore,

- kandidatet nga te gjitha komunitetet e Republikes se Kosoves; si dhe

-kandidatët nga të gjitha kategoritë tjera me pak të përfaqësuara në institucionet/organet/organizatat e vendit.

**NPL "Kuzhina Qendrore" Sh.A**

**Prishtinë, Dt. 25.08.2023**










## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Hera Healthcare SH.P.K., me seli në Prishtinë, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: 811466061.

- Edisona Syla shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme Ekonomike “Hoxhë Kadri Prishtina” Prishtinë.

- Ismet Tahiraj, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Arkitekt Sinani”, ish-shkollës “Brois Kidriç”.

- N.P.SH BEST WEY, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 811333880, “Bekim Shkreli B.I”.

- N.P.SH BEST WEY, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NR: 330433954, “Bekim Shkreli B.I”.

- Driton Hajrizi, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme “Arkitekt Sinani”.

- Albina Bucolli shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore nga kl. 1-9 të shkollës “Fazli Grajqevci” Poklek Vasilev komuna e Drenasit.

- Alban Bucolli shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore nga kl. 1-9 të shkollës “Fazli Grajqevci” Poklek Vasilev komuna e Drenasit.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.


100% Fresh & Natural
VIDAS
Llatte drink
2%
VIDAS
TAMËL
2,8%
VIDAS
Schmand
18% yndyrë
800g
VIDAS
JOGURT
VIDAS
DHALLË


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues